

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“CASTELLINO HOME” Sh.p.k.**

Ne Tirane, sot me daten 22.09.2022 (dymije e njezet e dy) shtetasit:

- 1 Z.Ilirik Dulo**
- 2 Z.Bledian Dulo**
- 3 Znj. Enni Qirjo**

Mblidhen, diskutojne, bien dakort dhe vendosin sa vijon:

NENI 1

Formohet shoqeria tregetare **CASTELLINO HOME Sh.p.k.**

Nga Ortake themelues:

- 1 Z.Ilirik Dulo**
- 2 Z.Bledian Dulo**
- 3 Znj. Enni Qirjo**

Emertimi i shoqerise do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise do te jete ne adresen:

**Njesia Bashkiake Nr 2 Autostrada Tirane Elbasan km 2 Godina nr 2 Kodi Postar 1003 Tirane.**

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne te gjithe juridiksionin territorial te Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me vendim te ortakeve, mund te krijohen ose anullohen seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

Njesite e tjera strukturore te shoqerise si dege apo perfaqesi edhe jashte shtetit krijohen kur nje gje te tille parashikon dhe lejon dhe legislacioni i vendeve te huaja, normat e se drejttes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve te ndryshme.

NENI 4

Kapitali i shoqerise

Kapitali i nënshtkuar i shoqërisë, është **3.600.000** (Tre milion e gjateqind mijë) lekë i ndare ne 3 kuota. dhe shperndarjes se Kuotave te kapitalit si me poshte :

Kuotat e kapitalit te Shoqërisë zotërohen nga ortakët si më poshtë:

- Zoti **Ilirik Dulo** zoteron 40% kuota ose **1.440.000** (Nje milion e katerqind e dyzet mijë) leke te kapitalit 1 kuote
- Zoti **Bledian Dulo** zoteron 30% kuota ose **1,080.000** (Njemilion e tetedhjet mijë ) leke te kapitalit 1 kuote
- Znj **Enni Qirjo** zoteron 30 % kuota ose **1.080.000** (Njemilion e tetedhjet mijë ) leke te kapitalit 1 kuote

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve. Ortaket mund te shesin kuotat e tyre personave te trete ne perputhje me dispozitat e legjislacionit te aplikuar dhe parshikimeve te statutit te kesaj Shoqerie.

Transferimi i Kuotave në rrugë trashëgimie bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe per gjithesish siç parashihet ne ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqerinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve. Në rastet e bashkëpronësisë veprohet ne zabatim te legjislacionit ne fuqi.

Kapitali mund te rritet me zhvillimin e veprimtarise ekonomike financiare te shoqerise dhe me investime personale te ortakeve konform miratimit paraprak te asamblese se ortakeve..

Ortaket kane te drejta pronesie mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge te ligjshme. Shoqeria per gjigjet vetem me kapitalin e saj.

#### NENI 5

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte me një afat te pacaktuar.

#### NENI 6

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plete me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi , ne perputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

#### NENI 7

Shoqeria çel llogari bankare ne monedhe shqiptare si edhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shteterore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financier të aktivitetit të saj.

Ortaket e Shoqerise ose Administratori i emeruar prej tyre, depozitojne faksimilet e firmave të tyre orgjinale ne Bankat ku eshte çelur llogaria bankare.

#### NEN I 8

Ortaket, kane të drejte të transferojne jashtë territorit të Republikës se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjesave të kapitalit themelor, Transferimet duhet të jene të vertetuara me Akt Notarial dhe per një gje të tille duhet të marre paraprakisht vendim me shkrim Asambleja e Ortakeve.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sa po tu behen të ditura.

#### NENI 9

Shoqeria krijohet per të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit qe do te jete :

Import-eksport, tregtim me shumice dhe pakice te artikujve industrial,prodhimin e produkteve industriale si dhe çdo lloj aktiviteti tjeter dytesor qe lidhet me ushtrimin e aktivitetit te mesiperm. Shoqeria do te kryej çdo veprimitari te ligjshme dhe/ose te angazhohet ne çdo lloj aktiviteti sipas legjislacionit shqipetar.

#### NENI 10

Me vendim të Asamblese se Ortakeve, shoqeria mund të zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtimet të tjera të cilat jane me interes per mbarvajtjen e shoqerise.

#### NENI 11

Me vendim të Asamblese se ortakeve, shoqeria mund të zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake të tjere, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me nje shoqeri tjeter tregtare si brenda vendit dhe jashte saj.

#### NENI 12

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte Organi me i Larte Drejtues dhe Vendimor i shoqerise dhe ai ushtron të gjitha kompetencat qe ligji " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare " i njeh asamblese se ortakeve qe jane krijuar me ortakeri.

Ortaket mund t'ia delegojne kompetencat nje ose me shume administratoreve të caktuar prej tyre ose dhe nje personi fizik jashte ortakerise se shoqerise, vetem mbi bazen e prokures.

#### NENI 13

Administrator i shoqerise **CASTELLINO HOME Sh.p.k.** eshte:

Duke filluar nga data e miratimit të këtij statuti, administratoret e shoqërisë "**CASTELLINO HOME**" shpk për një periudhë 5-vjeçare do të jenë

Znj. **Enni Qirjo**, madhor, lindur Elbasan e banues ne Tirane.

Administratori i shoqerise gezon te gjitha te drejtat qe ligji « Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare » parasheh, pa asnjë kufizim te kompetencave.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

#### NENI 14

Ky akt themelimi u redaktua ne 5 ekzemplare, ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera të njejtë juridike dhe eshte i vlefshem kur vertetimi i autenticitetit të nenshkrimit eshte bere nga Noteri.


### ASAMBLEA E ORTAKËVE

ILIRIK DULO

  
Ilirik Dulo

Tirane me , 22/09/2022

BLEDIAN DULO

  
Bledian Dulo

ENNI QIRJO

  
Enni Qirjo